


1. Përmbledhje ekzekutive

Gjatë vitit 2020, Ministria e Drejtësisë (MD) kishte planifikuar konsultimin e 7 (shtatë) projektakteve, 5 (pesë) projektligje dhe 2 (dy) projektvendime të Këshillit të Ministrave.

Gjatë vitit 2020, MD ka realizuar 100% planin e saj të konsultimit. Numri i përgjithshëm i projektakteve për të cilët ishte planifikuar konsultim gjatë vitit 2020 ishte 7 (shtatë) dhe ka realizuar procesin e konsultimit publik për të shtatë këto projektakte. Nga këto janë 5 (pesë) projektligje dhe 2 (dy) projektvendime. Dy projektligjetë konsultuara gjatë vitit 2020, janë të parashikuara në Planin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve (PPAP) 2020, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 837, datë 24.12.20, "Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2020", i ndryshuar me VKM nr. 150, datë 19.2.2020.¹ Ndërsa tre projektligje dhe dy projektvendimet të cilat iu nënshtruan procesit të konsultimit publik gjatë vitit 2020 nuk ishin të përfshira në PPAP 2020.



Nga 7 (shtatë) projektaktet e konsultuara gjatë vitit 2020, të gjitha janë miratuar.

Gjatë periudhës së monitorimit u miratuan 14 (katërbëdhjetë) projektvendime të fushës së përgjegjësisë së Ministrisë së Drejtësisë të parashikuara në PPAP 2020 për të cilat ajo ishte përgjegjëse, por për to nuk u zhvillua procesi i konsultimit pasi nuk janë në fushën e zbatimit të Ligjit nr. 146/2014 "Për konsultimin Publik". Shih listën e akteve të miratuara gjatë kësaj periudhe në Shtojca 2 bashkëlidhur.

Nga monitorimi i platformës së Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) vihet re se për këto projektakte ka patur një numër vizitorësh në rritje nga publikudhe për njërin prej tyre janë përcjellë rekomandime apo komente përmes RENJK, duke patur një numër prej 8055 vizitorësh në total për të shtatë projektaktet për të cilat

¹Shih në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2019/12/24/837>

është zhvilluar konsultimi publik. Situata e krijuar nga pandemia e COVID-19 ka ndikuar negativisht në pjesëmarrjen aktive të publikut në dhënien e kontributit për përmirësimin e projektligjeve. Ajo që identifikohet nga procesi i konsultimit i realizuar, edhe pse vihet re një përmirësim i këtij procesi gjatë kësaj periudhe, është nevoja për informim më të mirë të këtij të publik dhe pjesëmarrje më aktive e tij. Kjo përbën një ndër sfidat për t'u adresuar edhe më mirë nga institucioni ynë.

2. Analiza e konsultimeve të kryera në gjatë vitit 2020

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

2.1.1 Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Numri i përgjithshëm i akteve të planifikuara nga Ministria e Drejtësisë për konsultim publik gjatë vitit 2020 ishte 7 (shtatë) projektakte, si vijon:

1. Projektligji "Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesat në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale";
2. Projektligji "Për rregjistrimin e OJF-ve";
3. Projektligji "Për ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme"
4. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9062, datë 08.05.2003 'Kodi i Familjes', i ndryshuar "
5. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9695, datë 19.3.2007 'Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit', të ndryshuar ";
6. Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë së Edukimit Ligjor për Publikun 2019-2023";
7. Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2020, e të Pasaportës së indikatorëve".

5 (pesë) prej këtyre janë projektligje dhe 2 (dy) janë projektvendime të Këshillit të Ministrave. Vetëm 2 (dy) prej projektligjeve janë të përfshira në PPAP, ndërsa 3 (tre) projektligje dhe 2 (dy) projektvendimet nuk janë të përfshira në PPAP,² por të identifikuar nga Ministria e Drejtësisë si projekt-dokumente strategjike kombëtare me interes të lartë publik.³ PPAP 2020 parashikon gjithsej 24 projektakte për t'u miratuar gjatë vitit 2020 nga Ministria e Drejtësisë. Pra, MD-ja ka planifikuar për konsultim 10% të akteve të PPAP, kjo në përputhje me detyrimet për konsultim në kuadër të ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik".

Përzgjedhja e tyre është bërë në përputhje ligjin nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik". Në zbatim të nenit 1 të ligjit nr.146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" përcaktohet shprehimisht se ky ligj rregullon procesin e konsultimit publik për projektligjet dhe projektdokumentet strategjike kombëtare dhe vendore, dhe për pasojë nga ana jonë konsultimi publik është parashikuar të realizohet vetëm për projektaktet që kanë detyrimin

²Shih tekstin e PPAP në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2019/12/24/837>

³ Referuar nenit 1 dhe 4 të ligjit "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/11/ligj_nr_146_per_njoftim_konsultim_public_dt_30_10_2014_19918_1-2.pdf

për t'iu nënshtruar këtij procesi në përputhje me parashikimet e nenit 1 të ligjit të lartpërmendur. Ndërsa në nenin 4 të ligjit "Për njoftimin dhe konsultimin publik" është parashikuar lista e projektakteve që nuk i nënshtrohet procesit të konsultimit publik, siç janë çështjet e sigurisë kombëtare që përbëjnë sekret shtetëror, marrëveshjet ndërkombëtare, aktet normative të KM me fuqinë e ligjit, emergjenca civile dhe çështje të tjera të parashikuara me ligj. Janë planifikuar për konsultim publik vetëm projektligjet dhe projektdokumentat strategjikë duke përjashtuar projektvendimet në përputhje kjo me parashikimet e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik.

Numri i përgjithshëm i projekt-akteve të planifikuara për konsultim për vitin 2020 nga MD ishte 7 (shtatë), përkatësisht 5 (pesë) projektligje dhe 2 (dy) projektvendime. Konkretisht këto janë:

- Projektligji "Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesat në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale".
- Projektligji "Për rregjistrimin e OJF-ve"
- Projektligji "Për ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme"
- Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9062, datë 08.05.2003 'Kodi i Familjes', i ndryshuar"
- Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9695, datë 19.3.2007 'Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit', të ndryshuar";
- Projektvendim "Për Miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë së Edukimit Ligjor për Publikun 2019-2023"
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2020, e të Pasaportës së indikatorëve"



Fig.2: Projektaktet e konsultuara gjatë vitit 2020, sipas planifikimit në PPAP 2020

2.1.2 Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Të 7 (shtatë) këto projektakte i janë nënshtruar konsultimit publik. Pra, nga aktet e planifikuara për t'u konsultuar gjatë kësaj periudhe raportimi, janë konsultuar 100% e tyre.

2.1.3 Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse do të kishte të tilla)

Nuk kemi asnjë rast të mos konsultimit të projektakteve të planifikuara për konsultim.

2.1.4 Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, rregullore ministrore, etj.)?

Gjatë vitit 2020 i janë nënshtruar konsultimit 5 (pesë) projektligje dhe 2 (dy) projektvendime. Vetëm 2 (dy) nga projektligjet kanë qenë të përfshira në PPAP 2020, ndërsa 3 (tre) projektligje dhe 2 (dy) projektvendime nuk ishin të parashikuara në PPAP 2020. Pra vetëm 29% e projektakteve të cilat iu nënshtruan procesit të konsultimit publik kanë qenë të parashikuara në PPAP 2020 dhe 71% e projektakteve të konsultuara gjatë vitit 2020 nuk kanë qenë të planifikuara në PPAP 2020.



Fig.3: Projektakte të konsultuara gjatë vitit 2020, sipas përfshirjes në PPAP

2.2. Metodatat e konsultimit

Metodat e përdorura për konsultimin publik gjatë kësaj periudhe ishin 3 (tre):

1. konsultimi në faqen zyrtare të konsultimit publik,
2. tryeza të konsultimit me ekspertë,
3. nëpërmjet faqes zyrtare të Ministrisë duke kontaktuar me adresën e emailit të personave të kontaktit.

Të 5 (pesë) projektligjet e planifikuara për konsultim publik iu nënshtruan dy metodave të konsultimit, përmes RENJK dhe tryezave të konsultimit, ndërsa 2 (dy) projektvendimet iu nënshtruan të treja metodave të konsultimit.

2.2.1 Cilat ish-in metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistrin elektronik, postën elektronike, faqet e internetit, takimet publike, komitetet këshilluese, etj.)

Të 7 (shtatë) projektaktet e planifikuara për konsultim gjatë vitit 2020, u konsultuan përmes konsultimit në faqen zyrtare të konsultimit publik:

- Projektligji “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Ankesave të Ekzekutimit të Vendimeve Penale”;⁴
- Projektligji “ Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”;⁵
- Projektvendim “Për Miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, të Strategjisë së Edukimit Ligjor për Publikun 2019-2023”;⁶
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2020, e të Pasaportës së indikatorëve”.⁷
- Projektligji "Për ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme"⁸
- Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9062, datë 08.05.2003 ‘Kodi i Familjes’, i ndryshuar ”⁹
- Projektligji "Përdisa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9695, datë 19.3.2007 ‘Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit’, të ndryshuar ”;¹⁰




Fig. 4: Metodatat e konsultimit publik

Pra, 100% e akteve të planifikuara gjatë vitit 2020 u konsultuan nëpërmjet Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

⁴Shih në: <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/150>

⁵Shih në: <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/272>

⁶ Shih në: <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/267>

⁷<https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/171>

⁸Shih në: <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/287>

⁹ Shih në: <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/291>

¹⁰ Shih në: <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/290>

Gjithashtu, të 7 (shtatë) aktet e planifikuara për konsultim gjatë vitit 2020, u konsultuan përmes tryezave të konsultimit me ekspertë të realizuara nga grupi i punës së hartimit të akteve:

- Projektligji "Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Ankesave të Ekzekutimit të Vendimeve Penale"¹¹
- Projektligji "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse"¹²
- Projektvendimi "Për Miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, të Strategjisë së Edukimit Ligjor për Publikun 2019-2023"¹³
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2020, e të Pasaportës së indikatorëve".¹⁴

Dhe për 3 (tre) projektligjet e mëposhtme të cilat nuk ishin të planifikuara në PPAP 2020 u zhvilluan tryeza konsultimi me ekspertë të fushës dhe përfaqësues të grupeve të interesit:

- Projektligji "Për ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme"¹⁵
- Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9062, datë 08.05.2003 'Kodi i Familjes', i ndryshuar "
- Projektligji "Përdisa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9695, datë 19.3.2007 'Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit', të ndryshuar "

Pra, 100% e akteve të planifikuara për këtë periudhë u konsultuan nëpërmjet tryezave të konsultimit me ekspertë.

Vetëm dy nga projektaktet e planifikuara për konsultim gjatë vitit 2020, përkatësisht projektvendimi "Për Miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, të Strategjisë së Edukimit Ligjor për Publikun 2019-2023" dhe Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2020, e të Pasaportës së indikatorëve", përveç dy metodave të konsultimit të përmendura më sipër, i është nënshtruar dhe një metode të tretë të konsultimit përmes publikimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe thirrjes për dërgim elektronik të mendimeve.

2.2.2 Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Metoda që gjeneroi numrin më të madh të komenteve ishte ajo e tryezave të konsultimit. Numri i komenteve përmes konsultimit publik nëpërmjet regjistrimit elektronik për njoftimet

¹¹Informacion nga Drejtoria e Hartimit të Legjislacionit, organizuar gjatë periudhës janar-shkurt 2020 me pjesëmarrës profesorë të Fakultetit të Drejtësisë dhe ekspertë të fushës.

¹² Shpallja për konsultim publik është edhe në: <http://drejtesia.gov.al/newsroom/lajme-flash/shpallja-per-konsultim-publik-te-projektligjit-per-regjistrimin-e-organizatave-jofitimprurese/> dhe takimi u realizua Ministrinë e Drejtësisë në qershor 2020. Informacion nga Drejtoria e Hartimit të Legjislacionit.

¹³Shpallja për konsultim publik dhe thirrje për mendime e sugjerime edhe në: <http://drejtesia.gov.al/newsroom/njoftime/rishpallje-per-konsultim-publik-te-projekt-planit-te-veprimit-2020-2023-te-strategjise-per-edukimin-ligjor-te-publikut/> Informacion nga Drejtoria e Hartimit të Legjislacionit.

¹⁴<http://drejtesia.gov.al/newsroom/njoftime/ministria-e-drejtesise-koordinatori-kombetar-kunder-korrupsionit-perfundoi-procesin-e-rishikimit-te-planit-te-veprimit-2019-2023-ne-zbatim-te-strategjise-ndersektoriale-kunder-korrupsionit/>

¹⁵Informacion nga punonjës të Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit të cilët kanë qenë organizatorë dhe pjesëmarrës në takim.

dhe konsultimet publike ishin 12 (dymbëdhjetë) dhe përmes konsultimit me ekspertë të realizuara nga grupi i punës për hartimin e projektakteve ishte 73 (shtatëdhjetë e tre)¹⁶ dhe asnjë koment përmes publikimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.




Fig. 5: Numri i komenteve sipas metodave të konsultimit

2.2.3A organizoi ministria gjithashtu disa konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Drejtoria e Hartimit të Legjislacionit realizoi konsultimin paraprak për projektligjin “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”. Konsultimi u realizua në katërmujorin e parë të vitit 2020 me pjesëmarrje përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe pushtetit gjyqësor.¹⁷

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1 Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditët e kërkuara? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes?

Konsultimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike për të 7 (shtatë)aktet e planifikuara gjatë vitit 2020 u realizua në përputhje me ligjin nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, përkatësisht me nenin 15 të tij. Konsultimet patën një kohëzgjatje prej 20 ditësh nga data e publikimit, si vijon:

- për projektligjin “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesat në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale” filloi më datë 11.03.2019 dhe u mbyll më datë 08.04.2019;

¹⁶ Informacion nga Drejtoria e Hartimit të Legjislacionit.

¹⁷ Informacion nga punonjës të Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit.

- për projektligjin “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”, filloi më datë 10.06.2020 dhe u mbyll më datë 08.07.2020;
- Projektvendimi “Për Miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, të Strategjisë së Edukimit Ligjor për Publikun 2019-2023”, filloi më datë 06.05.2020 dhe u mbyll më datë 05.06.2020
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2020, e të Pasaportës së indikatorëve, filloi më datë 28.6.2019 dhe u mbyll më 25.07.2019.
- për projektligjin "Për ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme", filloi më datë 14.07.2020 dhe u mbyll më datë 12.08.2020;
- për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9062, datë 08.05.2003 ‘Kodi i Familjes’, i ndryshuar "filloi më datë 14.08.2020 dhe u mbyll më datë 11.09.2020;
- për projektligjin "Përdisa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9695, datë 19.3.2007 ‘Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit’, të ndryshuar,filloi më datë 14.08.2020 dhe u mbyll më datë 11.09.2020;

Projektligji “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesat në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale” është një projektakt i cili vjen i mbartur që nga viti 2019. Për pasojë procesi i konsultimit publik për këtë projektakt ka filluar që në vitin 2019, duke u publikuar në portalin e regjistrimit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike në periudhën 11.03.2019-08.04.2019. Pas përfundimit të afatit të konsultimit publik në regjistrimin elektronik, gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2020 janë zhvilluar tryeza konsultimi me qëllim përgatitjen e draftit final të projektligjit i cili është miratuar nga Këshilli i Ministrave me VKM nr.599, datë 29.07.2020.

Projektvendimi “Për Miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, të Strategjisë së Edukimit Ligjor për Publikun 2019-2023”, nuk është i parashikuar në listën e projektakteve të PPA 2020. Procesi i hartimit të këtij plani veprimi u krye në periudhën e kohës 19 dhjetor 2019 – 20 prill 2020. Gjatë procesit të konsultimit për periudhën janar-qershor 2020 janë zhvilluar katër tryeza konsultimesh përkatësisht në datën 14 shkurt 2020, datën 5 mars 2020, datën 6 mars 2020, të zhvilluara në ambjentet e Ministrisë së Drejtësisë. Ndërsa në datën 1 qershor 2020 është zhvilluar një takim online, përmes platformës eebex cisco (online),¹⁸me qëllim përgatitjen e projektaktit përfundimtar, i cili u miratua me VKM nr.878, date 11.11.2020 nga Këshilli i Ministrave.

Projektligji “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”, është i parashikuar në PPAP 2020. Në katërmujorin e parë të vitit 2020 strukturat teknike të Ministrisë së Drejtësisë bënë një vlerësim mbi rëndësinë ndërmarrjes së kësaj iniciative ligjore. Për këtë projektligj janë zhvilluar disa tryeza konsultimesh në Ministrinë e Drejtësisë përkatësisht në muajin maj 2020 dhe 2 korrik 2020 me pjesëmarrës ekspertë të fushës, përfaqësues nga institucione

¹⁸Adresa pr takim: <https://akshi.webex.com/akshi/j.php?MTIDem294e0d9e7a36ac0f9d46a43f80ec84db>

shtetërore dhe të organizatave jofitimprurëse ku janë diskutuar me hollësi të gjitha rekomandimet dhe komentet e përcjella. Gjithshtu ky projektligj u publikua dhe në portalin e regjistrimit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike. Më tej nga grupi I punës është hartuar drafti final i cili është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave në mbledhjen e datës 09.09.2020.

Projektvendimi "Për miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2020, e të Pasaportës së indikatorëve", nuk është i parashikuar në listën e projektakteve të PPA 2020. Ky projektvendim është një projektakt i cili vjen i mbartur që nga viti 2019. Për pasojë procesi i konsultimit publik për këtë projektakt ka filluar që në vitin 2019, duke u publikuar në portalin e regjistrimit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike në periudhën 28.06.2019-25.07.2019. Gjatë procesit të konsultimit për periudhën janar-qershor 2020 janë zhvilluar dy tryeza konsultimesh përkatësisht në datën 16 janar 2020 i zhvilluar në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë dhe në datën 30 prill 2020 është zhvilluar një takim online, përmes platformës eebex cisco me qëllim përgatitjen e projektaktit përfundimtar dhe përcjelljen e tij për miratim pranë Këshillit të Ministrave. Projektvendimi u miratua me VKM nr.516, date 01.07.2020.

Projektligji "Për ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme" nuk është i përfshirë në PPAP 2020. Procesi i hartimit të këtij projektligji ka filluar në qershor të 2020. Për këtë projektligj projektligj janë zhvilluar disa tryeza konsultimesh në Ministrinë e Drejtësisë përkatësisht në 11 shtator 2020, ku të pranishëm ishin përfaqësues të sektorit të ndërmjetësitimit për pasuritë e paluajtshme në vend¹⁹, përfaqësues nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, e të tjerë. Diskutimi i kryer ndërmjet të pranishmëve ka qenë intensiv, ku secili prej tyre është shprehur mbi draftin e projektligjit duke dhënë rekomandimet e veta. Përgjatë kësaj tryeze konsultimi, nga ana e Ministrisë janë dhënë të gjitha shpjegimet dhe sqarimet e mundshme në nivel teknik për çdo koment apo sugjerim të shfaqur nga ana e operatorëve në tregun e ndërmjetësitimit të pasurive të paluajtshme, duke u parashtruar dhe shpjeguar qasjen që është ndjekur nga Ministria e Drejtësisë dhe alternativat e mundshme që janë marrë në konsideratë gjatë draftimit të këtij projektligji, si dhe avantazhet dhe disavantazhet në rast implementimi të tyre në të ardhmen, duke ruajtur fokusin në synimet kryesore që drafti në fjalë kërkon të përmbushë. Takimi i dytë është zhvilluar më datë 15.09.2020 pranë Ministrisë së Drejtësisë, ku janë diskutuar me hollësi rekomandimet dhe komentet përkatëse, të cilat janë përcjellë nga këta subjekte në rrugë elektronike dhe me shkresë zyrtare²⁰. Pas vlerësimit të komenteve, u përgatit drafti final i cili u miratua me VKM nr.865, date 11.11.2020.

Projektligjet Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9062, datë 08.05.2003 'Kodi i Familjes', i ndryshuar" dhe "Përdisa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9695, datë 19.3.2007 'Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit', të ndryshuar" nuk kanë qenë të përfshira në PPAP 2020. Për këto projektakte është zhvilluar një tryezë konsultimi me 15 Shtator 2020- në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë ku të pranishëm ishin përfaqësues të organizatave jofitimprurëse që operojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave

¹⁹Përfaqësues nga Shoqata Shqiptare të Ndërmjetësve të Pronave (NAREA- National Albanian Real Estate Association), RE-MAX Albania (Real Estate Partners), Century 21 Albania, Shoqëria "Domus Estate Service" (DES) shpk etj.

²⁰ Me shkresë zyrtare kanë përcjellë sugjerime dhe komente subjektet vijues: Shoqata Shqiptare të Ndërmjetësve të Pronave (NAREA) me shkresën me nr. tonin 4918 prot., datë 04.08.2020; "Century 21 Albania" me shkresën me nr. 8 prot., datë 10.09.2020.

të fëmijëve/të miturve, përfaqësues të institucioneve shtetërore si Ministria e Brendshme dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përfaqësues të UNICEF, përfaqësues të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, përfaqësues të Komitetit Shqiptar të Birësimeve, avokatë e të tjerë.

Përgjatë kësaj tryeze konsultimi, Ministria e Drejtësisë dhe ekspertët e fushës që janë përfshirë në procesin e draftimit të projektakteve kanë dhënë të gjitha shpjegimet dhe sqarimet e mundshme në nivel teknik për komentet apo sugjerimet e dhëna përgjatë takimit nga pjesëmarrësit. Të dyja këto projektligje u miratuan në mbledhjen e datës 09.12.2020 të Këshillit të Ministrave.

Kontributet që janë përcjellë në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, nga institucionet e interesuara nëpërmjet postës elektronike drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, me anë të regjistrit elektronik në adresën <http://www.konsultimipublik.gov.al>, në adresën postare të Ministrisë së Drejtësisë Bulevardi "Zogu I-rë", Tiranë, si dhe në tryezat e konsultimit të zhvilluara në Ministrinë e Drejtësisë, janë mbledhur nga struktura përkatëse në Ministri.

Nga të 7 (shtatë) projektaktet e sipërpërmendura, periudha më e shkurtër e konsultimit publik është për projektligjin "Për ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme" dhe ajo më e gjatë për projektligjin "Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesat në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale", në kushtet kur ky i fundit është projektligj që vjen i mbartur nga viti 2019.

2.3.2 Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit për këtë periudhë ishte 9 (nëntë) muaj. Kjo përlllogaritje është bërë duke patur në vëmendje kohën (numrin e muajve) gjatë të cilës ka filluar puna për identifikimin e grupeve të interesit, zhvillimin e konsultimeve paraprake, hartimin e draftit, publikimin e tij në RENJK, marrjen dhe vlerësimin e komenteve dhe përgatitjen e një drafti final për secilin projektakt.

2.3.3 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Në krahasim me vitin e kaluar situata ka pasur përmirësime të dukshme të procesit të konsultimit, pasi interesi i publikut në procesin e konsultimit publik rezulton të jetë në rritje.

Gjatë vitit 2020 Ministria e Drejtësisë rezulton me një shkallë realizimi të procesit të konsultimit publik 100%, por jemi të mendimit se situata lidhur me këtë proces është përmirësuar në krahasim me vitin apo edhe vitet paraardhëse. Të dhënat e përfuara nga Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike tregojnë se numri i vizitorëve ka qenë në rritjepërkatësisht 8055 në total për vitin 2020 ndërsa në vitin 2019 numri i vizitorëve ka qenë 3116 në total, pavarësisht faktit se përcjellja e komenteve përmes këtij portali vazhdon të jetë në nivele të ulëta. Gjatë vitit 2020 vihet re një interes në rritje i organizatave jofitimprurëse në drejtim të përmirësimit të projektakteve.

Vlerësojmë se gjatë vitit 2020, një faktor që mund të ketë ndikuar në mungesën e reagimeve nga ana e publikut ka qenë dhe situata e krijuar nga pandemia botërore shkaktuar nga COVID-19.




Fig.6: Krahasim i numrit të vizitorëve të RENJK në 2019 dhe 2020

2.4. Palët e interesit të përfshira

2.4.1 Sa palë interesi të jashtme morën pjesë në grupet e punës për hartimin e akteve gjatë vitit? Sa eksperte ishin në tryeza?

Gjatë vitit 2020 aktorët pjesëmarrës ishin kryesisht ekspertë të fushës, përfaqësues të institucioneve shtetërore, përfaqësues të organizatave jofitimprurëse që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, partnerë ndërkombëtare, psikologë e punonjës socialë, si dhe profesorë të Fakultetit të Drejtësisë.

Konkretisht, në projektvendimin “Për Miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, të Strategjisë së Edukimit Ligjor për Publikun 2019-2023” procesi i hartimit u shoqërua nga një komunikim shumë intensiv bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të përfshira, dhe 7 (shtatë) ka qenë numri i ekspertëve pjesëmarrës në grupin e punës. Në lidhje me projektligjin “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse” kanë marrë pjesë 5 (pesë) ekspertë të fushës, kryesisht përfaqësues të organizatave jofitimprurëse dhe të institucioneve shtetërore. Në projektligjin “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesat në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale” në përbërje të grupit të punës për hartimin e tij kanë qënë 6 (gjashtë) ekspertë pjesëmarrës. Për projektaktin “Për miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2020, e të Pasaportës së indikatorëve” procesi i hartimit u shoqërua nga një komunikim i ngushtë ndërmjet institucioneve të përfshira dhe përfaqësuesve të organizatave jofitimprurëse duke patur dhe pjesëmarrje të 5 (pesë) ekspertëve në grupin e punës.

Për tre projektligjet e tjera të paparashikuara në PPAP 2020 në përbërje të grupit të punës kanë qenë pjesëmarrës ekspertë dhe përkatësisht në projektligjin “Për ndërmetësit e pasurive të paluajtshme” janë përfshirë 4 (katër ekspertë), ndërsa në projektligjet “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9062, datë 08.05.2003 “Kodi i Familjes”, i ndryshuar dhe për projektligjin “Përdisa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9695, datë 19.3.2007 ‘Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, të ndryshuar, 5 (pesë) ka qenë numri i ekspertëve pjesëmarrës në grupet e punës për hartimin e projektakteve.




Fig.7: Pjesëmarrja e ekspertëve në grupet e punës

Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individual, OSHC, kompani, etj.)

Për konsultimin e projektligjeve gjatë vitit 2020, pjesëmarrësit në tryezat e konsultimit ishin:

- ekspertë individual,
- përfaqësues nga organizatat jofitimprurëse,
- përfaqësues nga organizatat ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, dhe
- përfaqësues nga institucione publike të pavarura apo institucione të varësisë.

2.4.2 *Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të bëra për projekt-akte në vitin e caktuar?*

Gjatë procesit të konsultimit, kryesisht të gjithë pjesëmarrësit në tryezat e konsultimit kanë qenë aktivë duke dhënë sugjerime dhe komente, në drejtim të përmirësimit të cilësisë dhe përmbajtjes së projektakteve. Gjithashtu në të shumtën e rasteve komentet dhe rekomandimet e tyre janë përcjellë edhe me shkrim (në rrugë zyrtare apo nëpërmjet komunikimit elektronik), pas zhvillimit të tryezave përkatëse.

NUMRI I KOMENTEVE NË TRYEZAT E KONSULTIMIT PËR SECILIN PROJEKTAKT

- P/ligji për SHKBB
- P/ligji për ndërmjetësit e pasurive të paluajjtshme
- P/ligji për ndryshime në procedurat e birësimit
- Pvk m në zbatim të SNK
- P/ligji për OJF
- P/ligji për ndryshime në Kodin e Familjes
- Pvk m në zbatim të SELP




Fig.8: Numri i komenteve në tryezat e konsultimit për secilin projektakt

2.4.3 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Pjesa më e madhe e komenteve janë përcjellë kryesisht nga persona juridikë private dhe organizata ndërkombëtare, kryesisht përfaqësues të organizatave jofitimprurëse ku ndër të cilët mund të përmendim EURALIUS, Partners Albania, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, etj.

2.4.4 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara ka ardhur duke u përmirësuar. Kjo gjë konstatohet nga rritja e numrit të pjesëmarrësve në tryezat e konsultimit të organizuara nga Ministria e Drejtësisë. Gjithashtu, edhe një tjetër tregues rezulton dhe nga monitorimi i portalit të Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike pasi vërehet një rritje e numrit të qytetarëve që ndjekin projektaktet e publikuara në të. Numri total i vizitorëve për projektaktet e publikuara në vitin 2019 ka qenë 3116, ndërsa në vitin 2020 numri i vizitorëve ka qenë 8055. Këto të dhëna janë trajtuar dhe grafikisht përkatësisht në figurën 6.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

Gjatë periudhës së vitit 2020 kontributet e mbledhura në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, janë përcjellë nga institucionet e interesuara nëpërmjet postës elektronike drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, me anë të regjistrimit elektronik në adresën <http://www.konsultimipublik.gov.al>, në adresën postare të Ministrisë së Drejtësisë Bulevardi “Zogu I-rë”, Tiranë, si dhe nëpërmjet komenteve të drejtpërdrejta në tryezat e konsultimit të zhvilluara në Ministrinë e Drejtësisë.

Gjithashtu, duhet theksuar se gjatë vitit 2020 është sugjeruar nga disa organizata jofitimprurëse që të publikohen në RENJK dhe projektvendimet, pra duke e bërë të

detyrueshme procesin e konsultimit publik dhe për projektvendimet dhe jo vetëm për projektligjet apo projektdokumentet me strategji kombëtare siç parashikon aktualisht ligji nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

2.5.1 Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Numri i komenteve përmes konsultimit publik nëpërmjet regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike ishin 12 (dymbëdhjetë) dhe përmes konsultimit me ekspertë të realizuara nga grupi i punës për hartimin e projektakteve ishte 73 (shtatëdhjetë e tre)²¹ dhe asnjë koment përmes publikimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë. Referohu fig.5 lart.

2.5.2 Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Për të 7 (shtatë) projektaktet e konsultuara gjatë vitit 2020 numri total i komenteve të përcjella ka qenë 73 (shtatëdhjetë e tre), prej të cilave:

- 26 janë pranuar plotësisht
- 40 janë refuzuar plotësisht
- 7 janë pranuar pjesërisht .



Fig. 9: Numri i komenteve të pranuar dhe refuzuara

Pra, 36% e komenteve përcjella gjatë procesit të konsultimit publik të projektakteve janë pranuar, 9% e tyre janë pranuar pjesërisht dhe 55% janë refuzuar.

2.5.3 Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara ka ardhur duke u përmirësuar. Kjo gjë konstatohet nga rritja e numrit të pjesëmarrësve në tryezat e konsultimit të organizuara nga Ministria e Drejtësisë. Gjithashtu, edhe nga monitorimi i portalit të Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike vërehet një rritje e numrit të qytetarëve që ndjekin projektaktet e publikuara në të. Për analogji referohu tek grafiku i mësipërm në figurën 6.

²¹Informacion nga Drejtoria e Hartimit të Legjislacionit.

2.5.4 Cilat janë përfundimet/rezultatet kryesore nga procesi i konsultimit publik për periudhën e fundit

Procesi i konsultimit publik ka ardhur duke u përmirësuar nga viti në vit. Kjo vihet re në rritjen e numrit të tryezave të konsultimit të organizuara për diskutimin dhe përmirësimin e projektateve. Gjithashtu, gjatë vitit 2020 janë përdorur më shumë metoda konsultimi; jo vetëm konsultimi publik përmes RENJK, por dhe përmes tryezave të konsultimit dhe faqes zyrtare të internetit të MD-së.

2.5.5 Ndarja e praktikave më të mira nga procesi i konsultimit publik për periudhën e fundit

Nga praktikat më të mira për procesin e konsultimit publik mund të përmendim projektligjin “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, për të cilin rezultoni të kemi konsultime paraprake, tryeza konsultimi si dhe publikimin e projektaktit në portalin e RENJK. Përdorimi i disa mënyrave të konsultimit ka shtuar mundësinë e hartimit të një politike më efektive në këtë rast. E vlerësojmë si një nga praktikat më të mira sepse është i vetmi projektakt për të cilin janë përcjellë për herë të parë komente përmes regjistrimit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike. Gjithashtu ky projektligj jo vetëm që ka patur numrin më të madh të vizitorëve por ka shënuar dhe numrin më të lartë të komenteve sepse rreth 63% e komenteve të përcjella në total i referohen këtij projektakti.

2.6. Rezultatet e raporteve të konsultimeve

2.6.1 Sa raporte konsultimesh publikoi ministria?

2.6.2 Nëse disa nuk u botuan, cilat janë arsytet?

Për vitin 2020 Ministria e Drejtësisë ka hartuar raporte konsultimi për të gjitha projektaktet për të cilat ishte planifikuar procesi i konsultimit publik, 7 (shtatë) të tilla dhe janë publikuar në portalin e regjistrimit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (RENJK) vetëm 4 (katër) prej tyre.

3. Sfidat, rreziqet kryesore dhe mundësitë për të ardhmen

Sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik lidhen më së shumti me gjithëpërfshirjen e publikut në këtë proces. Ende nuk reflektohet qartësisht një kulturë e angazhimit në proceset e hartimit të politikave. Megjithë përpjekjet dhe mundësitë e ofruara nga Ministria e Drejtësisë, ende nuk ka përfshirje aktive të publikut në procesin e dhënies së rekomandimeve apo qëndrimeve për përmbajtjen e projektakteve që hartohen. Për periudhën e ardhshme, me qëllim përmirësimin e procesit, organizimi i konsultimeve është planifikuar të orientohet edhe më shumë përmes informimit më aktiv të publikut për përfshirjen në procesin e konsultimit publik. Mendojmë se për të përmirësuar procesin e konsultimit publik dhe për të siguruar një përfshirje sa më të madhe të publikut në këtë proces, është e nevojshme dhe zhvillimi i trajnimeve mbi procesin e konsultimit publik për të gjithë punonjësit që merren me hartim legjislativ.²² Kjo do të mundësonte një njohje dhe përdorim edhe më të mirë e të shtuar të metodave gjatë procesit të konsultimit publik dhe rritjen e pjesëmarrjes së publikut në konsultimin e projektakteve.

²² Më 7.02.2020, Ministria e Drejtësisë mori pjesë me tre përfaqësues të saj, në trajnimin e zhvilluar nga Zyra e Kryeministrit me mbështetjen e Projektit “Technical Assistance for improving Regulatory framework and Public Consultation”, i cili ishte mjaft i frytshëm, por është e nevojshme që ky trajnim të pasohet nga trajnime të tjera për konsultimin publik.

Shtojca 1. Lista e projektakteve të konsultuara nga Ministria e Drejtësisë gjatë vitit 2020

Tabela më poshtë pasqyron projektaktet të cilat janë të parashikuara në PPAP për konsultim publik përvitin 2020 dhe që i janë nënshtruar konsultimit.

Bashkëlidhur në formatin excel .

Shtojca 2. Lista e projektakteve të miratuara për periudhën janar-dhjetor 2020, të përfshira në PPAP 2020

1. Projektvendimi “Për organizimin dhe funksionimin e arkivit gjyqësor”, i parashikuar në PPA 2020 – katër mujori I, është miratuar me VKM nr.888, datë 31.12.2019 (ky është përfshirë në këtë raport për shkak të faktit që është pjesë e PPAP të vitit 2020).
2. Projektvendimi “Për procedurën e detajuar për kredinë për shtëpi për magjistratët dhe marrëveshjet me bankat”, i parashikuar në PPA 2020 – katër mujori I, është miratuar me VKM nr.22, datë 20.01.2020.
3. Projektvendimi “Për miratimin e rekomandimeve prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm, në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2020”, i parashikuar në PPA 2020 – katër mujori I, është miratuar me VKM nr.501, datë 24.06.2020.
4. Projektvendimi “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri Elektronik i Ekspertëve”, i parashikuar në PPA 2020-katër mujori I, është miratuar me VKM nr.502, datë 24.06.2020.
5. Projektvendimi “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për garantimin e rregullit e të sigurisë në gjykata dhe prokurori”, është miratuar me VKM nr.538, datë 08.07.2020.
6. Projektvendimi “Për përcaktimin e kushteve dhe të mënyrës së përfitimit të mbrojtjes së veçantë të garantuar nga shteti për përmbaruesin gjyqësor” është miratuar me VKM nr.620, datë 29.07.2020.
7. Projektvendimi “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Institutit të Mjekësisë Ligjore” është miratuar me VKM nr.680, datë 2.09.2020.
8. Projektvendimi “Për kriteret e caktimit të shpërblimit të administratorit të përkohshëm të falimentimit, rregullat për shpërblimin e administratorit të falimentimit, si dhe kriteret dhe përlogaritja e shpërblimit të kujdestarit” është miratuar me VKM nr.705, datë 9.09.2020.
9. Projektvendimi “Për miratimin e planit të veprimit 2020–2023, në zbatim të Strategjisë së Edukimit Ligjor për Publikun 2019–2023”, është miratuar me VKM nr.878, datë 11.11.2020
10. Projektvendim “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e vlerës së sendit në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm” është miratuar me VKM nr.970, datë 4.12.2020
11. Projektvendim “për politikat e përgjithshme shtetërore, për sistemin e teknologjisë së informacionit, për sistemin e drejtësisë” është miratuar me VKM nr.971, datë 2.12.2020
12. Projektvendimi “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë” është miratuar me VKM nr.972, datë 2.12.2020

13. Projektvendim “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore “Sistemi i Deklarimit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit –EACIDS” është miratuar me VKM nr.330, datë 22.4.2020
14. Projektvendim “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për garantimin e rregullit e të sigurisë në gjykata dhe prokurori” është miratuar me VKM nr.538, datë 8.7.2020